

V E N D I M
Nr. 55, datë 5.9.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË KOMISIONET
E PËRHERSHME TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

I. Në komisionet e përhershme bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Agron Tato caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm për të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet në vend të deputetit Blendi Klosi, si dhe anëtar i Komisionit të Përhershëm për Arsimin, Kulturën, Shkencën e Sportet.

2. Deputeti Ilir Zela caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm për Politikën e Jashtme në vend të deputetit Fatos Nano dhe deputeti Marko Bello caktohet anëtar i këtij Komisioni në vend të deputetit Ilir Meta.

3. Deputetja Ermelinda Meksi caktohet anëtare e Komisionit të Përhershëm për Ekonominë, Financat dhe Privatizimin në vend të deputetit Arben Malaj.

4. Deputeti Ardit Kaja caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm të Mbrojtjes.

5. Deputeti Fatmir Xhafa caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore dhe i Komisionit të Përhershëm të Mbrojtjes.

6. Deputeti Ndre Legisi caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm për Rendin dhe SHISH-in në vend të deputetit Spartak Poçi dhe Stefan Çipa caktohet anëtar i këtij Komisioni në vend të deputetit Ben Blushi.

7. Deputeti Et'hem Ruka caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm për Arsimin, Kulturën, Shkencën e Sportet.

8. Deputeti Maqo Lakrori caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm për Industrinë, Punët Publike dhe Tregtinë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI